



Shtojca 3

PLANI I TARIFAVE DHE I DETYRIMEVE ADMINISTRATIVE TË DHOMËS

Tarifat e arbitrazhit.

- Me depozitim e kërkesës për zgjidhjen e mosmarrveshjes me arbitrazh, nëpërmjet Rregullave të Dhomës Shqiptare të Arbitrazhit, pala kërkuese duhet të parapaguajë në momentin e dorëzimit një vlerë minimale prej 25.000 (njëzet e pesë mijë) lekësh, vlerë e cila në rast të marrjes në shqyrtim të kërkesës do të zbritet nga tarifa e përgjithshme e padisë. Në rast se Dhoma prima facie (sipas përcaktimeve të nenit 3) konstaton se kërkesa nuk plotëson kushtet dhe e kthen atë, tarifa e parapaguar nuk i kthehet kërkuarit.

	Vlera e objektit të padisë në Leke	Tarifa për 1 Arbitër	Tarifa për 3 Arbitra	Tarifa e padisë
		LEKE	LEKE	LEKE
Midis	0 deri në 500.000	60.000	120.000	25.000
Midis	500.001 deri në 1.000.000	80.000	150.000	35.000
Midis	1.000.001 deri në 2.000.000	120.000	210.000	50.000
Midis	2.000.001 deri në 5.000.000	150.000	240.000	70.000
Midis	5.000.001 deri në 10.000.000	200.000	360.000	100.000
Midis	10.000.001 deri në 20.000.000	300.000	450.000	1.5% e vlerës
Midis	20.000.001 deri në 50.000.000	400.000	810.000	1.5% e vlerës
Midis	50.000.001 deri në 200.000.000	800.000	1.200.000	1.5% e vlerës
Midis	200.000.001 deri në 500.000.000	1.000.000	1.500.000	1.5% e vlerës
Midis	Mbi 500.000.001	1.500.000	2.100.000	1.5% e vlerës

- Për vlera të mosmarrveshjes më të mëdha se 500.000.000 (pesëqind milionë) lekë tarifat dhe kostot administrative jepen me kërkesë.
- Tarifat dhe kostot administrative për çdo mosmarrveshje janë ato të specifikuar në diapazonin e shkallës që mbulon vlerën e asaj mosmarrveshjeje. Tarifat dhe kostot administrative për diapazonet e shkallëve më të vogla nuk duhet të shtohen.
- Për qëllimet e aplikimit të diapazonit të shkallës, vlera që duhet të merret në konsideratë do të jetë totali i pretendimeve të paraqitura nga palët, pra i padive dhe kundërpadive.
- Nëse llogaritja e vlerës së mosmarrveshjes është e pamundur, kjo vlerë do të përcaktohet nga Dhoma, duke marrë në konsideratë elementet e vlefshme të përfshira në këtë dosje.
- Dhoma mund të modifikojë diapazonin e shkallës, si dhe tarifat dhe detyrimet administrative të zbatueshme për një çështje, duke i rritur ose reduktuar ato në rrethana të veçanta, në përputhje me dispozitat e nenit 9.6 të këtyre Rregullave.
- Janë arbitrat ata që vendosin nëse vlera e tarifave që duhet t'i paguhet Dhomës do të ndahet midis tyre në tri pjesë të barabarta apo 40% për Kryetarin dhe 30% për secilin prej arbitrave.

Arbitrazhi Urgjent

- Për sa u përket procedurave të Arbitrazhit Urgjent, aplikanti duhet të paguajë përpara se të depozitohet alikimin dhe t'i bashkëngjisë atij dëshminë e kësaj pagese:

	Vlera e objektit të padisë në Leke	Tarifa për 1 Arbitër	Tarifa e padisë	Totali
		LEKE	LEKE	LEKE
Midis	0 deri në 5.000.000	100.000	100.000	200.000
Midis	5.000.001 deri në 20.000.000	250.000	150.000	400.000
Midis	20.000.001 deri në 50.000.000	350.000	200.000	550.000
Midis	50.000.001 deri në 200.000.000	500.000	350.000	850.000
Midis	200.000.001 deri në 500.000.000	1.000.000	500.000	1.500.000
Midis	Mbi 500.000.001	1.500.000	700.000	2.200.000